



PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 18.03.2026
PRIMLJENO:

M.No.Bn. 02/69



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I (parë) inauguruese të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

REND I DITËS

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës
3. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës

Mbledhja u mbajt, më datë **03.12.2025** duke filluar nga ora: **10:20**.

Në mbledhje morën pjesë **27** asambleistë, Kryetari i Komunës **Ekrem Kastrati**, nënkryetari **Vesel Krasniqi**, përfaqësues nga **Policia e Kosovës**, përfaqësues nga **OVL-UÇK**, përfaqësues nga **Bashkësia Islame** në Malishevë, **medie** dhe **Zyra për Informim**.

Enver Hoti (kryeson Kuvendin si anëtar i vjetër):

Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë inauguruese! Uroj Kryetarin, asambleistët e komunës së Malishevës për arritjet dhe rezultatet në këto Zgjedhje Lokale! Prezent në mbledhje janë **27** asambleistë.

Prezent në mbledhje janë:

- | | |
|-------------|----------|
| 1. Halil | Morina |
| 2. Remzi | Hoti |
| 3. Hafir | Rexha |
| 4. Avdi | Morina |
| 5. Amrush | Helshani |
| 6. Gentianë | Memheti |
| 7. Edonë | Hoti |
| 8. Bashkim | Berisha |
| 9. Gazmend | Begaj |

10. Sylë	Dukolli
11. Valbona	Morina
12. Bashkim	Krasniqi
13. Rukije	Bytyçi
14. Muvledin	Mazreku
15. Burim	Paçarizi
16. Demir	Bajra
17. Imran	Xhyliqi
18. Valjetë	Hoti
19. Mërgime	Robaj Gashi
20. Fatmir	Ademaj
21. Xheneta	Morina
22. Fitim	Shala
23. Egzonë	Paçarizi
24. Veton	Zogaj
25. Arben	Krasniqi
26. Vlëra	Bytyçi
27. Enver	Hoti

Konstatohet që kuorum ka dhe mund të vazhdojmë me punimet e seancës. Të nderuar asambleistë, ju ftoj që në mënyrë solemne, ta thoni betimin tuaj, si anëtarë të asamblesë:

*Unë **Enver Hoti** betohem solemnisht se do t'i kryej detyrat me nder, besnikëri, të paanëshme e me ndërgjegje, dhe sipas ligjit do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.*

Betohem!

Urime të gjithëve!

E ftoj Kryetarin **Ekrem Kastrati** ta bëjë betimin para të gjithëve:

Ekrem Kastrati, (Kryetar i Komunës së Malishevës), bazuar në nenin 52 të Ligjit për Qeverisje Lokale, në rastin e zgjedhjes së Kryetarit të Komunës jap betimin para anëtarve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.

*Unë, **Ekrem Kastrati** betohem që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat që më takojnë si Kryetar i Komunës së Malishevës, me nder dhe besnikëri në mënyrë të paanëshme e ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për jetesë të qetë për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës.*

Enver Hoti (kryeson Kuvendin si anëtari më i vjetër): Të nderuar të pranishëm, anëtarë të asamblesë, e ftoj Kryetarin të marrë një fjalën përshëndetëse.

Ekrem Kastrati -Kryetar i Komunës së Malishevës:

*Të nderuar familjarë të dëshmorëve të kombit,
Invalidë dhe veteranë të ushtrisë çlirimtare,
I nderuar kryetar i familjeve të dëshmorëve,
I nderuar komandant i Stacionit Policor,
Të nderuar ish-kryetarë të Komunës së Malishevës,
Anëtarë të sapozgjedhur të Komunës së Malishevës,
Të nderuar drejtorë të Administratës Komunale,
Të dashur qytetarë të Komunës së Malishevës*

Sot pas dhënies së betimit dal para jush me këtë emocion, me shumë mirënjohje dhe shumë përgjegjësi. Qytetarët e Malishevës ma kanë besuar për herë të dytë rradhazi drejtimin e Komunës sonë, kjo nuk është thjesht një fitore zgjedhore, është një mesazh i qartë që ju ma keni dhënë mua dhe ekipit tim, që për katër vjet kemi punar fort dhe në katër vjetët e ardhshme do të punojmë edhe më shumë.

Për mua personaisht është mandati i dytë pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe në tetor të vitit 2025, derisa për subjektin tonë politik të cilit jam i nderuar që i përkas, Nisma Socialdemokrate, ky është mandati i 4 radhazi që si subjekt i ka fituar zgjedhjet. Kjo vazhdimësi nuk është privilegj, por është përgjegjësi për t'u përgjigjur para qytetarit dhe për t'i shërbyer sa më shumë atij.

Të nderuar të pranishëm, Malisheva jonë, zemra e Llapushës, nuk është thjesht një ndjesi administartive, por është një histori e tërë e sakrificave, në të gjitha etapat e ushtrisë sonë kombëtare. Llapusha dhe Malisheva jonë kanë dhënë burra e gra që u rreshtuan në vijën e parë për atdheun dhe lirinë. Gjatë viteve të "90-ta Malisheva ishte ndër të parat që ia çjerrën maskën sistemit të atëhershëm, duke u bërë streha dhe bazamenti i shumë veprimeve ilegale.

Në territorin e Komunës sonë u vendosën shumë nga institucionet e ushtrisë çlirimtare të Kosovës, ndërkohë në brigadat tona krenare u ngrit zëri i lirisë dhe nga këto troje liria mori hov. Kjo komunë dhe dhjetra dëshmorë e qindra martirë, dhe shumë të zhdukur, familje të tëra që sakrifkuan, emrat dhe gjaku i tyre janë të gdhendur përgjithëmonë në fjalën liri me fjalën çlirim dhe me emrin e Malishevës. Prandaj sot para se të flasim për të tashmen dhe të ardhmen ne përkulemi me respekt të thellë para atyre të cilët mundësuan që ne sot të jemi të lirë të zgjedhim lirisht dhe të punojmë lirisht për komunën tonë.

Lavdi e përjetshme të gjithë dëshmorëve dhe martirëve.

Të dashur qytetarë, kur e kam marrë mandatin tim të parë në vitin 2021, bashkë e nisëm një rrugëtim që e quajtmë: Malisheva Urbane! Nuk ishte thjesht një slogan, por ishte një zotim, një vizion, një kontratë me ju. Sot pas katër vjetsh mund të them me modesti, por edhe me krenari që Malisheva ka nisiur të ndryshojë imazhin dhe pamjen e saj.

Sheshi i dëshmorëve së bashku me parkingun nëntokësorë dhe nënkalimin janë më shumë se projekte inxhenerike, janë një monument i përhershëm për të rënë tanë dhe një hap i madh drejt një qyteti modern e funksional.

Bulevardi "Ibrahim Mazreku" është shndërruar në zemrën e jetës urbane, aty kur dikur kishim nevojë sot kemi dhe cilësi, aty kur dikur mungonte hapësira, sot kemi frymëmarrje për familjet dhe bizneset. Rrugët, trotualet, ndriçimi publik; infrastruktura rrugore dhe kanalizimet në shumë fshatra kemi ofruar standarte të jetës.

Në arsim kemi hapur çerdhe të reja, duke përfshirë qindra fëmijë në edukimin e hershëm, kemi renovuar objekte shkollore kemi përkrahur studentët tanë të ecin përpara në jetë; në shëndetësi, kemi investuar në Qendrën e Mjeksisë Familjare, kemi shtuar mjekë dhe infermierë; kemi garantuar vazhdimësinë në shërbimet esenciale, dhe kemi qenë pranë pacientëve tanë.

Fermerët tanë i kemi përkrahur në subvencione në mekanizmat bujqësor dhe politikat që e bëjnë më të lehtë pranimin dhe dorëzimin e qumështit. Kemi qëndruar afër familjeve në nevojë, kemi ndërtuar shtëpi dhe banesa sociale, kemi bashkëpunuar me diasporën tonë, e cila vazhdon të jetë shtyllë e fuqishme e zhvillimit të Malishevës.

Në Kulturë, Rini dhe Sport Malisheva jonë sot nuk është vetëm pjesë e hartës, por është pjesë e agjendës kombëtare me aktivitete e festivale, investime në infrastrukturë sportive dhe hapësira të reja për të rinjtë tanë.

Të gjitha këto nuk i kam bërë unë i vetëm, janë punë e një ekipi të tërë, punë të drejtorëve, të Adinistratës komunale, të Asablesë komunale, të bashkëpunëtorëve të shumtë dhe mbi të gjitha janë punë të qytetarëve tanë, që na kanë shtyrë, na kanë besuar, na kanë mbështetur dhe na kanë dhënë të drejtën.

Faleminderit edhe njëherë nga zemra për besimin tuaj më 12 tetor, atë të vitit 2021 dhe e përsëritët fuqishëm edhe në vitin 2025. Më keni bërë nderim më të madh në jetën time, por ky nder për mua është detyrim, nuk ka vend për t'u mburrur, por për t'u përlulur para juve. Më keni dhënë një mesazh shumë të fortë se këto katër vjet keni parë punë, keni parë lëvizje përpara, keni parë seriozitet dhe tani presim edhe më shumë.

Edi shumë mirë se vota juaj nuk është dhuratë, vota juaj është detyrim dhe obligim dhe unë këtë kontratë do ta respektojë çdo ditë nga ky mandat.

Sot zotohem dhe dua t'ju them qartë, unë jam kryetar i të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës pa dallim e kahje politike, përkatësi fetare, gjinie apo fshati e lagje; jam kryetar i çdo familjeje të kësaj komune, i të moshuarëve që presin më shumë kujdes; i të rinjve që kërkojnë mundësi, të cilët ëndrrojnë dhe vazhdojnë të punojnë në vendlindjen tonë.

Ju premtoj sot para jush dhe para vetes time, se në këtë mandat të dytë do të jem edhe më i hapur, më i vëmendshëm ndaj çdo shqetësimi tuaj. Nëse ndonjëherë gjatë mandatit të parë kam dështuar, nuk jam përgjigjur me kohë, nuk ju kam kthyer telefonatat apo mesazhet ju kërkojë ndjesë sinqerisht. Do të përpiqem të jem më i mirë, më i kujdesshëm dhe më i pranishëm.

Të nderuar anëtarë të Asablesë komunale, sot kemi një mbledhje solemne apo inauguruese, disa jeni për herë të parë, e disa edhe me përvojë, por sot të gjithë bashkë kemi një përvojë të përbashkët, t'i shërbejmë Malishevës. Ne mund të vijmë nga parti të ndryshme, nga lista të ndryshme, por sapo u ulëm në këtë sallë – mbaroi fushata dhe filloi përgjegjësia. Ju ftoj që katër vjetët e ardhshme të jenë vite edhe më të forta dhe të drejta të kritikës së sinqert, por konstruktive, vite të konkurrencës së ideve e jo pengimit të projekteve, do ta dëshojmë se Malisheva është shembull i bashkëpunimit politik për të mirën e qytetarit.

Të nderuar përfaqësues të Policisë, të Kforit dhe shoqërisë civile, medie, roli juaj në jetën e kësaj komune është i pazëvendësueshëm, siguria dhe rendi, harmonia fetare, shoqëria civile aktive dhe medie janë themeli i një komune demokratike dhe funksionale. Ju falënderoj sinqerisht për bashkëpunimin në mandatin e parë dhe ju ftoj që këtë bashkëpunim ta zgjerojmë edhe më tepër. Komuna e Malisheves ka nevojë për ju po aq sa kemi nevojë për institucionet tona komunale.

Të dashur qytetarë, para nesh kemi edhe katër vjet të reja pune, kemi projekte që duhet t'i përfundojmë, kemi premtime që duhet t'i mbajmë, kemi ide të reja që duhet t'i kthejmë në realitet. Do ta çojmë deri në fund projektin e Malishevës Urbane, do të vazhdojmë të investojmë në Sheshin e Dëshmorëve, do të forcojmë rolin e Bulevardit "Ibrahim Mazreku" si qendër e jetës sociale dhe ekonomike. Do të angazhojmë shoqërinë që rinia të ketë jetë, shumë më të mirë dhe me mundësi të reja, që gratë të kenë më shumë hapsirë, që mërgata jonë të ketë më shumë arsye të investimit. Transparenca, llogaridhënia dhe puna e ndershme do të jetë busulla e këtij mandati. Çdo qytetarë i Malishevës do të jetë i informuar, i respektuar dhe i përfaqësuar. Në fund më lejoni edhe njëherë t'ju falënderoj nga zemra për besimin e madh që më keni dhënë, ky besim është forca ime, por është edhe përgjegjësia ime më e madhe. Le të vazhdojmë bashkë këtë rrugëtim për Malishevën që nuk e harron historinë e saj; për Malishevën që nderon sakrificën e dëshmoreve të saj; për Malishevën që punon, që zhvillohet që bën çdo ditë Malishevën Urbane më moderne për të gjithë. Urme mandati për anëtarët e Asamlesë komunale, urime të gjithë qytetarëve të komunës së Malisheves. Ju falënderit nga zemra për gjithçka. Zoti na ndihoftë dhe na priftë e mbara në këto katër vjetët e ardhshme!

Enver Hoti (kryeson Kuvendin si anëtari më i vjetër): Të nderuar të pranishëm vazhdojmë sipas rendit të ditës. Rendi i ditës ka të bëjë me nënshkrimet e asambleistëve komunale, janë dy lista të cilat duhet t'i nënshkruani për prezencën tuaj, ndaj sipas rradhës do t'ju ftojë një nga një që të nënshkruani.

- | | |
|--------------|-------------|
| 1. Halil | Morina |
| 2. Remzi | Hoti |
| 3. Hafir | Rexha |
| 4. Avdi | Morina |
| 5. Amrush | Helshani |
| 6. Gentianë | Memheti |
| 7. Edonë | Hoti |
| 8. Bashkim | Berisha |
| 9. Gazmend | Begaj |
| 10. Sylë | Dukolli |
| 11. Valbona | Morina |
| 12. Bashkim | Krasniqi |
| 13. Rukije | Bytyçi |
| 14. Muvledin | Mazreku |
| 15. Burim | Paçarizi |
| 16. Demir | Bajra |
| 17. Imran | Xhyliqi |
| 18. Valjetë | Hoti |
| 19. Mërgime | Robaj Gashi |
| 20. Fatmir | Ademaj |
| 21. Xheneta | Morina |
| 22. Fitim | Shala |
| 23. Egzonë | Paçarizi |
| 24. Veton | Zogaj |
| 25. Arben | Krasniqi |
| 26. Vlera | Bytyqi |
| 27. Enver | Hoti |

Enver Hoti (kryeson Kuvendin si anëtari më i vjetër): I nderuar kryetar urime edhe njëherë në emër të të gjithë asambleistëve, të uroj suksese, shëndet dhe punë të mbarë dhe realizim të të gjitha detyrave, përgjegjësive dhe mundësive për të ecur përpara, për zhvillim i cili është në interes të të gjithëve. Po ashtu meqenëse më ka rënë fati ta kryesoj këtë mbledhje, shfrytëzoj rastin të gjithë asambleistëve të gjitha grupeve politike, të cilët kanë fituar të drejtën edhe mundësinë për të qenë zëri i qytetarëve të Malishevës.


Urime edhe njëherë të gjithëve edhe si grupe politike, edhe si asambleistë, shëndet dhe suksese, ju priftë e mbara!

Ju përshëndes dhe ju falënderoj të gjithëve për prezencën tuaj!

Mbledhja përfundoi në ora **11:00**

Procesmbajtëse:

Argenitë Thaçi



Kryesuesi i mbledhjes

Enver Hoti

